



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:098591

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05619511

P.nr.296/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunatoren profesionale Vlora Selmani Rahimi, në çështjen penale ndaj të pandehurit B... M... nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.329/2023 të datës 26.04.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 11.04.2024, mori, ndërsa me datë 22.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit: B... M..., nga babai E...dhe nëna F..., e lindur H...., i lindur më, në H... Komuna e K...., me vendbanim në Gjilan, rr, i pa martuar, me profesion moler, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R S E P S E

Më datë 15.02.2023, rreth orës 20:30 minuta, në Gjilan, në, afër barnatores, i pandehuri B.. M., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka hapur derën e veturës të llojit "C", të cilin e dëmtuara A... M.. kishte parkuar dhe kishte hyr në barnatore, e nga aty në ulësen e parme, në anën e pasagjerit ka marrë një telefon ngjyrë rozë model iphone 6, një paqetë cigare dhe një shkrepës e më pas është larguar, me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

- Me çka, ka kryer veprën penale, **Vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38,43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72, të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurin Besfort Morina :

E GJYKON

I.Me dënim me gjobë, në shumë prej 150(njëqindë e pesëdhjetë) euro, i cili denim do të paguhet nga data pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

II.Dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy), viteve duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepra tjetra penale.

III. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil.

IV.Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 26.04.2023 ka ngritur aktakuzën e lartë cekur, ndaj të akuzuarit B... M... nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së.Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 11.04.2024 ku prezent ishin prokurori i shtetit, i pandehuri, i pandehuri i lartcekur pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se e pranon fajsinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë penale, ekziston fakti se i pandehuri nga Gjilani, ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata merr për bazë rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil konform nenit 462 paragrafi 1 i KPRK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 296/2023-Më 14.04.2024

Bashkëpunatore profesionale

Vlora Selmani Rahimi

Gjyqtari,

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi pala e dëmtuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.